



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
BORDI I EDUKIMIT TË VAZHDUESHËM

Nr. 415 Prot.

Tiranë, më 06-07 2016

VENDIM

Nr. 05, datë 06-7 2016

PËR

**RREGULLOREN PËR ORGANIZIMIN E PROVIMIT TË CERTIFIKIMIT PËR
PROFESIONISTËT E SHËNDETËSISË**

Në mbështetje të nenit 33 “Edukimi i Vazhdueshëm Profesional”, të ligjit nr.10107, datë 30.03.2009 “Për kujdesin Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Bordi i Edukimit të Vazhdueshëm,

VENDOSI:

Miratimin e “Rregullores Për Organizimin e Provimit të Certifikimit për Profesionistët e Shëndetësisë” sipas tekstit bashkëngjitur këtij vendimi.

MINISTRI
ILIR BEGALLI

RREGULLORE PËR ORGANIZIMIN E PROVIMIT TË CERTIFIKIMIT PËR PROFESIONISTËT E SHËNDETËSISË

Kjo rregullore nxirret në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 10107, datë 30.03.2009 “Për Kujdesin Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe pikës IV/4 të VKM nr.789 dt. 22.09.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, standardeve dhe procedurave të programit të certifikimit për profesionistë të shëndetësisë”.

Neni 1

Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim të përcaktojë rregullat dhe mënyrën e organizimit të provimit të certifikimit për profesionistët e shëndetësisë që nuk përmbushin kërkesat e programit të certifikimit.

Neni 2

Përkufizime

Në kuptim të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- a) “Provimi i certifikimit” është kontrolli i njohurive dhe aftësive të profesionistit që ushtron profesionin e tij në shërbimet shëndetësore publike ose jo publike, i cili nuk ka plotësuar detyrimet e programit të certifikimit të ciklit përkatës.
- b) “Programi i certifikimit” është procesi i bazuar në cikle periodike, brenda të cilit profesionistët duhet të mbledhin një numër të caktuar kreditesh të edukimit në vazhdim bazuar në procedurat, kriteret dhe standardet e paracaktuara.
- c) “Pjesëmarrës në provim” quhet profesionisti i cili nuk ka përmbushur kërkesat e programit të certifikimit për profesionistët e shëndetësisë.

Neni 3

Provimi i certifikimit

1. Provimi i certifikimit kryhet për të vlerësuar nivelin e njohurive dhe kompetencave të profesionistëve që nuk janë angazhuar plotësisht në edukimin e tyre në vazhdim gjatë një cikli certifikimi dhe për të garantuar përputhjen me kërkesat bashkëkohore të praktikës profesionale.
2. Përmbajtja e provimit hartohet nga Komisioni i Provimit të Certifikimit, në përputhje me fushën e veprimtarisë profesionale dhe me zhvillimet e reja shkencore në këtë fushë. Provimi i certifikimit do të zhvillohet për çdo fushë specialiteti.

3. Pas përfundimit me sukses të provimit, pjesëmarrësit në provim i jepet dëshmia përkatëse nga Bordit i Edukimit të Vazhdueshëm, e cila dorëzohet pranë Urdhrit Profesional.

4. Përfshihet nga detyrimi për të dhënë provimin:

a) Profesionisti i punësuar në shërbim publik shëndetësor, i cili për 2 vjet ose më pak arrin moshën e pensionit.

b) Profesionisti, i cili ka marrë lejen e ushtrimit të profesionit për herë të parë 2 vjet përpara përfundimit të ciklit të certifikimit.

c) Profesionisti që ka mbushur 75 vjet deri në datën e përfundimit të ciklit të certifikimit.

Neni 4

Autoritetet përgjegjëse

1. Bordi i Edukimit të Vazhdueshëm është autoriteti përgjegjës për lëshimin e dëshmive të certifikimit të profesionistëve që kanë përmbytur kërkesat e programit si dhe kanë dalë të suksesshëm në provimin e certifikimit përmes Agjencisë Kombëtare të Provimeve.

2. Urdhri Profesional (UP) përkatësisht UMSH, UFSH dhe USSH është bashkëpërgjegjës për hartimin e programit të provimit të certifikimit.

3. Institucionet e sistemit shëndetësor janë përgjegjëse për zbatimin e detyrimeve të miratuara nga Bordit të Edukimit të Vazhdueshëm për profesionistët që nuk kanë përmbytur kërkesat e programit të certifikimit në përfundim të ciklit.

4. Qendra Kombëtare e Edukimit në Vazhdim (QKEV) është autoriteti që administron regjistrimin e profesionistëve dhe krediteve të tyre në regjistrin kombëtar të certifikimit. QKEV administron dhe procesin e administrimit të provimit të certifikimit.

Neni 5

Lista e pjesëmarrësve në provim

1. QKEV harton listën e profesionistëve që nuk kanë përmbytur detyrimet e programit të certifikimit dhe Ministria e Shëndetësisë e bën atë publike.
2. Të gjithë profesionistët e listës së cituar në pikën 1 të këtij neni duhet të regjistrohen pranë QKEV për të kryer provimin. Lista e pjesëmarrësve në provim, dërgohet nga QKEV në AKP ose në Komisionet e provimit të certifikimit, sipas formatit të përcaktuar paraprakisht nga AKP. QKEV mban përgjegjësi për saktësinë e hartimit të listës së pjesëmarrësve në provim.

Neni 6

Komisioni i provimit të certifikimit

Për secilën fushë të specialitetit, Ministri i Shëndetësisë miraton një komision të provimit të certifikimit.

Komisioni i provimit të certifikimit përbëhet nga:

- a) Një përfaqësues i Ministrisë së Shëndetësisë.
- b) Një përfaqësues i UP.
- c) Tre përfaqësues nga personeli akademik i institucionit të arsimit të lartë, të cilët kanë titullin shkencor “as/profesor” dhe “profesor”, një nga të cilët është kryetar i komisionit.

Përbërja e komisionit të provimit të certifikimit për secilën fushë të specialitetit përcillet nga Ministria e Shëndetësisë në Agjencinë Kombëtare të Provimeve dhe i bëhet me dije antarëve të komisioneve përkatëse.

Neni 7

Periudha e zhvillimit të provimit

Datat e provimit të certifikimit për secilën fushë të specialitetit caktohen nga Ministria e Shëndetësisë. Në rastet kur provimi zhvillohet pranë AKP datat caktohen nga Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me AKP.

Neni 8

Programi i provimit

Programi orientues i provimit të certifikimit shpallet së paku 3 muaj përpara datës së parë të provimit në faqen zyrtare të Ministrisë së Shëndetësisë. Ai hartohet nga departamentet përkatëse të Universitetit të Mjekësisë dhe Urdhrat Profesionalë në bashkëpunim me shoqatat e profesionistëve.

Neni 9

Zhvillimi i provimit

Në rastet kur numri i pjesëmarrësve në provim për një specialitet të caktuar është më i vogël se 50 vetë, atëherë provimi do të zhvillohet më shkrim pranë Komisionit të Provimit të Certifikimit.

Hartimi i tezave të provimit me shkrim pranë Komisionit të Provimit të Certifikimit, bëhet nga Komisioni i Provimit të Certifikimit. Pyetjet e provimit janë pyetje me zhvillim.

Kur numri i pjesëmarrësve në provim për një specialitet të caktuar është më shumë se 50, provimi do të zhvillohet pranë AKP me fond të hapur pyetjesh. Hartimi i fondit të pyetjeve për zhvillimin e provimit të certifikimit pranë AKP, bëhet nga Komisioni i Provimit. Hartuesit e fondit të pyetjeve ndërtojnë fondin e pyetjeve me përgjigjet përkatëse, për provimin e certifikimit, me të paktën 4 (kater) përgjigje, nga të cilat vetëm njëra është përgjigja e saktë.

Hartuesit hartojnë fondin e pyetjeve në bazë të standardeve të përcaktuara nga AKP, si dhe bëjnë grupimin e tyre, si më poshtë:

- i. Në pjesë/module sipas grupeve kryesore të fushave të specialitetit;
- ii. Nivele vështirësie: Niveli I- i lehtë, Niveli II: mesatar dhe Niveli III- : i vështirë, duke u konvertuar respektivisht në 1 pikë, 2 pikë dhe 3 pikë.

Gjatë hartimit të fondit të pyetjeve, hartuesit duhet të zbatojnë standardet për hartimin e pyetjeve me alternativa të miratuara nga Agjencia Kombëtare e Provimeve. Hartuesit kanë përgjegjësi për saktësinë e pyetjeve të hartuara nga ana e tyre dhe për zbatimin e Ligjit nr. 9380, datë 28.04.2005 "Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të", i ndryshuar.

Neni 10

Pagesat për Provimin e Certifikimit

Pagesat për Provimin e Certifikimit janë të njëjta me ato të provimit të shtetit. Për provimin që zhvillohet në Agjencinë Kombëtare të Provimeve, kjo e fundit është përfituese e pagesës. Për provimin që zhvillohet pranë Komisionit të Provimit të Certifikimit, Qendra Kombëtare e Edukimit në Vazhdim është përfituese e pagesës.

Neni 11

Detyrat e Komisionit të Provimit të Certifikimit

1. Kur provimi zhvillohet nga Komisioni i Provimit të Certifikimit

- a. Komisioni i Provimit të Certifikimit duhet të ketë parapërgatitur jo më pak se 7(shtatë) teza para paraqitjes së profesionistëve për provim. Tezat janë me nga tre pyetje me zhvillim secila

me përmbajtje brenda programit orientues për specialitetin përkatës, dhe në përputhje me zhvillimet e reja shkencore në këtë fushë. Teza ka 100 pikë në total.

- b. Ditën e provimit, para fillimit të provimit, Komisioni i Provimit të Certifikimit do të sistemojë në sallën e provimit të gjithë profesionistët e paraqitur në provim. Vendosja në sallë organizohet në mënyrë që profesionistët të kenë sa më pak mundësi komunikimi midis tyre.
- c. Lista emërore e profesionistëve të regjistruar për provim i vihet në dispozicion nga QKEV Komisionit të Provimit të Certifikimit ditën e provimit.
- d. Cdo profesionisti i verifikohet identiteti përmes përputhshmërisë së emrit në listën emërore të profesionistëve të regjistruar për provim, me dokumentin personal të identifikimit që ka me vete. Çdo profesionisti pjesëmarrës në provim i shpërndahen mjetet didaktike.
- e. Pas përfundimit të gjithë proceseve të përshkruara më lart mbahet shënim nga komisioni orari i saktë i fillimit të provimit dhe që nga ky moment provimi do të zgjasë maksimumi 2 orë.
- f. Komisioni i Provimit të Certifikimit duhet të jetë i pranishëm gjatë kohës së zhvillimit të provimit të certifikimit.
- g. Nëse profesionisti e përfundon provimin para përfundimit të kohëzgjatjes maksimale ai dorëzon fletën e provimit dhe largohet. Komisioni para marrjes në dorëzim verifikon që në fletën e provimit të jetë vendosur emri (emer, atësi, mbiemër) i profesionistit.
- h. Pas përfundimit të kohëzgjatjes maksimale të provimit komisioni mbledh provimet e profesionistëve që nuk e kanë dorëzuar ende fletën e provimit duke verifikuar në çdo rast vendosjen e emrit (emer, atësi, mbiemër) në fletën e provimit.
- i. Komisioni i Provimit të Certifikimit korigjon provimet brenda 5 ditëve punë dhe plotëson procesverbalin e provimit me rezultatet, i cili firmoset nga të gjithë anëtarët e komisionit. Modeli i procesverbalit të provimit i bashkëngjitet kësaj rregulloreje.

2. Kur provimi zhvillohet nga AKP

- a. Komisioni i Provimit të Certifikimit i dorëzon AKP brenda 7 (shtatë) ditëve kalendarike, fondin e miratuar të pyetjeve me alternativat përkatëse të përgjigjeve ku saktësohet përgjigja e saktë.
- b. Komisioni i Provimit të Certifikimit duhet të jetë i pranishëm në ditën e zhvillimit të provimit të certifikimit.
- c. Komisioni asiston në prodhimin elektronik të tezës së provimit të certifikimit dhe kryen kontrollin e saj, para se ajo t'i shpërndahet kandidatëve. Nga komisioni mbahet procesverbali përkatës për saktësinë e pyetjeve të përzgjedhura nga sistemi për tezën përkatëse.

- d. Komisioni ndjek gjatë gjithë kohës procedurat dhe zhvillimin e provimit të certifikimit pranë AKP-së deri në përfundimin e tij dhe firmosjen e procesverbalit me rezultatet e provimit;
- e. Bashkëpunon me AKP për mbarëvajtjen e provimit të informatizuar certifikimit.
- f. Përgjigjet për saktësinë e fondit të pyetjeve dhe përgjigjeve respektive për çdo program specialiteti;

Neni 12

Regjistrimi dhe pranimi në provim

1. Profesionisti i cili njoftohet për detyrimin për të kryer provimin e certifikimit duhet të bëjë një kërkesë me shkrim për t'u regjistruar për provim pranë QKEV.
2. Lista e profesionistëve të regjistruar që do të kryejnë provimin dërgohet nga QKEV në Komisionin e Provimit të Certifikimit (kur numri i të regjistruarve për secilin specialitet në përfundim të regjistrimit për provim është më pak se 50 vetë) ose në AKP (kur numri i të regjistruarve për secilin specialitet në përfundim të regjistrimit për provim është më shumë se 50 vetë)
3. Kërkesës për regjistrim duhet t'i bashkëngjiten dokumentet e mëposhtëm:
 - a) fotokopje e kartës së identitetit
 - b) fotokopje e lejes së ushtrimit të profesionit
 - c) fatura e pagesës për provimin e certifikimit

AKP publikon listën e pjesëmarrësve në provimin e certifikimit në faqen e saj zyrtare, dhe datat e zhvillimit të provimit.

Neni 13

Mënyra e zhvillimit dhe administrimit të provimit të certifikimit që zhvillohet nga Komisioni i Provimit të Certifikimit

1. Provimi i certifikimit me shkrim nga Komisioni i Provimit të Certifikimit do të zhvillohet në datat e përcaktuara sipas nenit 7 të kësaj rregulloreje në mjediset e Fakultetit të Mjeksisë dhe Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza".
2. Ditën e zhvillimit të provimit, pjesëmarrësit në provim duhet të kenë parasysh rregullat e mëposhtme:

- a. të jenë të pajisur me dokument identiteti (kartë identiteti ose pasaportë), si dhe me një fotokopje të saj;
 - b. ndalohet mbajtja dhe përdorimi i telefonave celularë dhe mjeteve të tjera të komunikimit gjatë zhvillimit të provimit, pasi kjo vlerësohet si kriter skualifikimi;
 - c. ndalohet komunikimi gjatë zhvillimit të provimit.
3. Salla e provimit mbikqyret nga anëtarët e Komisionit të Provimit të Certifikimit, të cilët janë përgjegjës për mbarëvajtjen e provimit sipas rregullave të përcaktuara në këtë rregullore.

Neni 14

Mënyra e zhvillimit dhe administrimit të provimit të certifikimit që zhvillohet nga zhvillohet nga AKP

1. Provimi i certifikimit nga AKP do të zhvillohet në datat e përcaktuara sipas nenit 7 të kësaj rregulloreje, bazuar në disponibilitetin e mjediseve të provimit të përcaktuara nga AKP.
2. Ditën e zhvillimit të provimit, pjesëmarrësit në provim duhet të kenë parasysh rregullat e mëposhtme:
 - a. të jenë të pajisur me dokument identiteti (kartë identiteti ose pasaportë), si dhe me një fotokopje të saj;
 - b. ndalohet mbajtja dhe përdorimi i telefonave celularë dhe mjeteve të tjera të komunikimit gjatë zhvillimit të provimit, pasi kjo vlerësohet si kriter skualifikimi;
 - c. ndalohet komunikimi gjatë zhvillimit të provimit.
3. Sallat e provimit mbikqyren nga një ose më shumë administratorë, të cilët janë përgjegjës për mbarëvajtjen e provimit sipas rregullave të përcaktuara në këtë rregullore.

Neni 15

Modalitetet e zhvillimit të provimit të certifikimit

1. Nëse një profesionist nuk paraqitet në provim ose tërhiqet përpara fillimit të tij, atëherë provimi nuk vlerësohet si i kryer.
2. Tërheqja nga provimi i certifikimit nuk mund të kryhet pas hyrjes në sallën e provimit.
3. Profesionisti që del nga salla e provimit nuk do të ri hyjë në sallën e provimit.

4. Në rast se profesionisti do të tërhiqet nga provimi i certifikimit pas fillimit të provimit, në përfundim të provimit duhet të firmosë deklaratën me rezultatin e marrë.
5. Kur provimi zhvillohet nga AKP, testi i provimit të certifikimit hartohet me 50 pyetje me pyetje me alternativa, me përgjigje me jo më pak se 4 (katër) alternativa, nga të cilat vetëm njëra duhet të jetë e saktë. Testi i provimit të certifikimit administrohet nga AKP, sipas modelit të provimit të provimit të shtetit.
6. Kur provimi zhvillohet nga AKP, për çdo seancë provimi, pyetjet e përzgjedhura nga sistemi në mënyrë automatike janë të njëjta për të gjithë kandidatët pjesëmarrës në provimin e informatizuar.
7. Kur provimi zhvillohet nga AKP, provimi i certifikimit zgjat 60 minuta dhe zhvillohet në një raund të vetëm në AKP. Ai fillon dhe mbaron njëkohësisht për të gjithë pjesëmarrësit në provim, në ditën dhe orarin e caktuar.

Neni 16

Vlerësimi i provimit

1. Provimi i certifikimit cilësohet i kryer me sukses nëse profesionisti ka marrë të paktën 50% të pikëve maksimale.
2. Kur provimi zhvillohet nga AKP:
 - a. Nëse konstatohet se provimi nuk është zhvilluar sipas rregullave, atëherë për pjesëmarrësit e kësaj sale, provimi do të vlerësohet si jo i kryer. Vendimi në këtë rast është në kompetencë të AKP-së dhe Komisionit të Provimit të Certifikimit.
 - b. Vlerësimi i pjesëmarrësve kryhet në mënyrë automatike nga sistemi kompjuterik në momentin e përfundimit të provimit. Rezultati përfundimtar i shfaqet pjesëmarrësit në monitor dhe printohet në mënyrë automatike nga sistemi së bashku me përgjigjet e dhëna. Çdo pjesëmarrës firmos fletën me rezultatet e provimit të printuar në përfundim të provimit përkatës.
 - c. AKP-ja ka të drejtë që në rast se evidenton shkelje të rënda të rregullave të provimit, t'i propozojë Komisionit të Provimit të Certifikimit, përjashtimin e pjesëmarrësit që thyen rregullat. AKP-ja mban procesverbal ku evidenton shkeljet e konstatuara.
3. Kur provimi zhvillohet nga Komisioni të Provimit të Certifikimit, Komisioni i Provimit të Certifikimit ka të drejtë që në rast se evidenton shkelje të rënda të rregullave të provimit të mos kualifikojë pjesëmarrësit që thyjnë rregullat. Komisioni i Provimit të Certifikimit mban procesverbal ku evidenton shkeljet e konstatuara.

Neni 17

Shpallja e rezultateve

1. Rezultatet e provimit të certifikimit që zhvillohen nga AKP bëhen nga kjo e fundit, e cila i përcjell UP-ve dhe MSH-së listën e rezultateve të provimit të certifikimit. Rezultatet e provimit të certifikimit që zhvillohen nga Komisioni i Provimit të Certifikimit bëhen nga ky i fundit, i cili i përcjell UP-ve dhe QKEV-së listën e rezultateve të provimit të certifikimit.
2. Shpallja e rezultateve bëhet sipas numrit të lejes së ushtrimit të profesionit dhe jo të emrit të profesionistit.
3. Përdorimi i rezultateve të provimit të certifikimit nga autoritetet përgjegjëse bëhet në përputhje dhe zbatim të dispozitave të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale".

Neni 18

Përsëritja e provimit

Profesionisti pjesëmarrës në provim ka të drejtë të përsërisë provimin e certifikimit në një kohë të dytë jo më shumë se 5 herë.

Neni 19

E drejta e ankimit

1. Profesionisti pjesëmarrës në provim ka të drejtë të verifikojë përgjigjet e dhëna dhe të kontestojë rezultatin me një ankesë me shkrim brenda 30 ditëve nga shpallja e rezultatit.
2. Ankimi duhet të depozitohet në Ministrinë e Shëndetësisë, e cila kërkon vendimin e Komisionit të Provimit të Certifikimit dhe kthen përgjigje të argumentuar brenda 30 ditëve.

Neni 20

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**PROCESVERBAL I PROVIMIT TE CERTIFIKIMIT TE ZHVILLUAR NGA KOMISIONI I
PROVIMIT TE CERTIFIKIMIT**

Procesverbal i rezultateve të provimit të ricertifikimit të mbajtur më datë..... për specialitetinme Komision të Provimit të Certifikimit të përbërë nga: 1. _____(kryetar), 2. _____(anëtar), 3. _____(anëtar), 4. _____(anëtar), 5. _____(anëtar)

Nr. Rendor	Profesionisti (Emri, Atesia, Mbiemri)	Rrethi	Pikët e Provimit	Rezultati (Kalon/ngel)
1.				
2.				
....				

.....

(Kryetar)

.....

(Anëtar)

.....

(Anëtar)

.....

(Anëtar)

.....

(Anëtar)

Përmbledhja e komenteve të pereflektuara në rregulloren e mësipërme:

Fatmir Brahimaj

1. Neni 9. Provimi të jetë me gojë, në formë të një bashkëbisedimi, ku komisioni të përqëndrohet në pyetjet mbi risitë tek problemi që dikutohet. Kjo formë e provimit lehtëson dhe marrjen e rezultatit të provimit direkt pas tij.

Linda Pustina

1. Neni 9: Propozohet që numri i të regjistruarve që provimi të bëhet në AKP të bëhet nga 50 në 15 vetë të regjistruar për çdo specialitet.

Gjithashtu propozohet që: Fakti që nuk kryhet në AKP të mos ndryshojë mënyrën e zhvillimit të provimit. Provimi të jetë i njëjtë me të njëjtat pyetje si në Komisionet e Provimit të Certifikimit dhe në AKP. Pyetjet e përgatitura për në AKP të përzgjidhen me short për t'u përdorur në komisione që të mos lihet vend për abuzime.

2. Neni 11: Provimi pranë komisioneve të zhvillohet me fletë të sekretuara siç kryet në AKP dhe kohëzgjatja dhe numri i pyetjeve të tij të jenë të njëjtë me provimin e zhvilluar në AKP.